



REPUBLIKA E MAQEDONISË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA 1 Nr. 08-96
16.06.2023
Shkup

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 22, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10¹, neni 70 dhe neni 75 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21, në pajtim me nenin 4 paragrafi (1) nënparagrafi 6, nenin 88 dhe nenin 93 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15), dhe në lidhje me Konkursin Publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, publikuar në bazë të Vendimit për shpallje të konkursit publik, PA1 nr.08 -98, datë 9.3.2023, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 55/23) dhe Vendimi PA1 nr. 08-192, datë 16.6.2023 për refuzimin e Kërkesës për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në rajonin e komunës së Tetovës, paraqitur nga personi juridik Universiteti Tetovë - Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë PA1 nr.08-192, datë 17.5.2023, në pajtim me Konkluzionin ark. nr. 02-2414/4 datë 15.6.2023, në seancën e 19-të mbajtur më 15.06.2023, miratoi si vijon:

V E N D I M

1. Konkursi publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës të destinuar për popullatën studentore, në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, e cila do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike e RMV-së, përkatësisht: 107.2 MHz , e publikuar në bazë të Vendimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal PA1 nr.08-98 datë 9.3.2023. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 55/23), nuk është i suksesshme për faktin se në afatin e përcaktuar për paraqitjen e aplikacioneve, sipas konkursit në fjalë, respektivisht deri më 15.5.2023. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia) nuk ka pranuar asnjë aplikacion të vetëm që plotëson kushtet e përcaktuara në konkurs.

2. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia) në lidhje me Letrën e dorëzuar për hapjen e radiostacionit nga pala e interesuar, Universiteti i Tetovës – Sektori i Kërkimeve Shkencore (Njësia me veprimtari kërkimore shkencore) , Tetovë, ark.nr.02- 32/1 datë 1.2.2023 (Nr.ynë ark 08-611/1 datë 1.2.2023), Njoftimi lidhur me kërkesën për informim për frekuencë të lirë për transmetim në radio të programit në nivel lokal për qytetin

¹ Paragrafët (8) dhe (9) janë fshirë, shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

e Tetovës nga Agjencia për Komunikime Elektronike ark. nr 0805 -449/2 datë 17.2.2023 (Nr ynë ark. 08-611/4, datë 20.2.2023) dhe Studimi për përcaktimin e arsyetimit të shpalljes së konkursit publik për dhënien e lejes për radio jofitimprurëse në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës Nr.ynë ark.03 -986/1 datë 3.3.2023, në seancën e 9-të mbajtur më 3.8.2023 ka miratuar Vendim (PA1 nr. 08-98, datë 9.3.2023) për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, destinuar për popullatën studentore, në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, e cila do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike të RMV-së, përkatësisht: 107.2 MHz. Vendimi i cituar është shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 55/23, në dy gazetat ditore: "Sloboden pečat" dhe "Koha" më 14.3.2023 dhe në ueb faqen e Agjencisë (www.avmu.mk).

Në pajtim me pikën 12 të Vendimit të lartpërmendur për shpallje të konkursit publik, aplikimi për pjesëmarrje në konkursin publik paraqitet në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, afat i cili është në rrjedhë nga dita e parë pas publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve për konkursin në fjalë ishte deri më 15.5.2023.

Në afatin e përcaktuar për paraqitjen e aplikacionit për konkursin publik në fjalë, respektivisht deri më 15.5.2023, në Agjencion, më datë 17.5.2023, ka ariturr 1 (një) Aplikacion i noterizuar me PA1 nr. 08-192, datë 17.5.2023 nga Universiteti i Tetovës – Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë, i dërguar më 12.5.2023, në afatin e paraparë Ligjor, me dokumentacion shoqërues.

Hapja publike e Aplikacionit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publik nga kandidati i lartpërmendur është mbajtur 5 (pesë) ditë pas skadimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, respektivisht më 22.5.2023, në të cilin aplikacioni i dorëzuar është shqyrtuar nga aspekti nëse është i rregullt, në kohë dhe i plotë, respektivisht nëse i përmban të gjitha dokumentet e përcaktuara në nenin 73 paragrafi (3) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV). Në hapje publike, u mbajt Procesverbali i hapjes publike të aplikimit për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal në zonën e Komunës së Tetovës PA1 nr.08-192 të datës 22.5.2023.

Sipas Procesverbalit të hapjes publike PA1 nr.08-192, datë 22.5.2023, të pranishmit në hapjen publike të aplikacionit - persona të punësuar në Shërbimin Profesional të Agjencisë, deklaruan se aplikimi në fjalë ishte me kohë, respektivisht është dorëzuar brenda afatit, pas së cilës në periudhën prej 23.5.2023 deri më 31.5.2023, sektori kompetente në Shërbimin Profesional të Agjencisë, iu drejtuan vlerësimit të Aplikimit të paraqitur PA1 nr. 08-192, datë 17.5.2023, me dokumentacionin shoqërues. Njëkohësisht është konstatuar se nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në konkursin publik, gjegjësisht në Aplikacionin në fjalë, edhe pse janë paraqitur të gjitha dokumentet nga aspekti programor (Koncepti i programit, Orari i programit javor dhe Përshkrimi i programit të planifikuar përmbajtjeve/emosioneve), për shkak të gabimeve në plotësimin e tyre, nuk mund të kryhet pikësimi. Konkretisht, në Formularin e konceptit programor, parashtuesi i kërkesës nuk ka treguar se sa orë program do të transmetohet të dielën, dhe sipas Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, radiot jofitimprurëse duhet të transmetojnë së paku 4 orë program në ditë gjatë javës; të dhënat për kohëzgjatjen e programeve të paraqitura në Strukturën e programit të planifikuar javor nga Formulari i konceptit programor ndryshojnë nga të dhënat për kohëzgjatjen e llojeve të programeve të paraqitura në Skemën e programit javor dhe në Përshkrimin e përmbajtjes së programit të planifikuar. Të dhëna të ndryshme janë evidentuar për programet nga të tre funksionet e medias (informative, edukative dhe argëtuese) dhe për shkak të gabimeve në plotësimin e Formularit për konceptin programor, ai nuk mund të përdoret si bazë për vlerësimet e ardhshme të zbatimit të konceptit programor në pajtim me nenin 67 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, Drejtori i Agjencisë drejtuar Këshillit të Agjencisë ka dorëzuar Propozimin nr.08-192 datë 14.6.2023 për miratim të Vendimit për refuzimin e aplikacionit për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e komunës së Tetovës, parashtuar nga personi juridik Universiteti i Tetovës - Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë PA1 nr. 08-192 datë 17.5.2023. Kështu, Këshilli i Agjencisë

në seancën e 19-të mbajtur më 15.6.2023, në pajtim me Konkluzionin ark. nr.02-2414/3 datë 15.6.2023 miratoi Vendim PA1 nr. 08-192, datë 16.6.2023, me të cilin rrëzohet Kërkesa për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për Institucionin Radiodifuziv Jofitimprurës për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e Komunaës së Tetovës, të paraqitur nga personi juridik Universiteti i Tetovës - Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë PA1 nr. 08-192 të datës 17.5.2023, për faktin se nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në konkursin publik .

Neni 75 paragrafi (1) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele parasheh se konkursi publik për dhënie të lejes për transmetim në televizion dhe radio është i suksesshëm nëse pranohet së paku një aplikim që i plotëson kushtet e përcaktuara në konkurs.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, dhe duke pasur parasysh faktin se në afatit e përcaktuar për paraqitjen e aplikacioneve në Agjenci nuk është pranuar asnjë aplikim që i plotëson kushtet e përcaktuara në konkurs, në lidhje me Konkursin Publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim se konkursi publik në fjalë nuk është i suksesshëm. Rrjedhimisht, Këshilli i Agjencisë në pajtim me Konkluzionin ark.nr. 02-2414/4, datë 15.6.2023, në seancën e 19-të mbajtur më 15.6 2023, mori vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.